

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Schmitz Cargobull AG, me seli të regjistruar në Bahnhofstraße 22, 48612 Horstmar, Republika Federale e Gjermanisë, përmes Shoqërisë së Avokatëve "Qoku dhe Partnerët" nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 30.06.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Schmitz Cargobull AG, me seli të regjistruar në Bahnhofstraße 22, 48612 Horstmar, Republika Federale e Gjermanisë, do të fitojë kontrollin mbi Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H., me seli të regjistruar në Rettenbach 10a, 6241 Radfeld, Republika e Austrisë, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 04.06.2026, i plotësuar më datë 08.06.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Schmitz Cargobull AG, me seli të regjistruar në Bahnhofstraße 22, 48612 Horstmar, Republika Federale e Gjermanisë, me të cilin Schmitz Cargobull AG do të fitojë kontrollin e vetëm mbi Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H., me seli të regjistruar në Rettenbach 10a, 6241 Radfeld, Republika e Austrisë, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, shtojcave dhe aneks-dokumente të tyre, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Schmitz Cargobull AG synon të fitojë kontroll të pavarur mbi Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H. aktualisht është nën kontrollin e përbashkët të Schmitz Cargobull AG dhe Berger Transport GmbH. Rrjedhimisht, lloji i kontrollit që ushtron Schmitz Cargobull AG mbi Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H. do të ndryshojë nga i përbashkët në të pavarur si pasojë e transaksionit të propozuar.

Schmitz Cargobull AG është një shoqëri familjare e themeluar në Gjermani, e cila prodhon dhe shpërndan gjysmërimorkio dhe rimorkio. Schmitz Cargobull AG prodhon produkte për transportin e mallrave në industri të ndryshme, duke përfshirë industrinë e ushqimit, të pijeve, të mallrave të ngrira, industrinë farmaceutike, bujqësinë dhe pylltarinë, shërbimet e korrierëve, materialet e ndërtimit dhe industrinë e automobilave.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Schmitz Cargobull AG realizon të hyra dhe ka prani të regjistruar përmes shoqërisë së varur në vijim – Shoqëria për tregti dhe shërbime SCHMITZ CARGOBULL MACEDONIA SHPKNJP Ilinden, me seli të regjistruar në rr. „34“ nr. 3 Ilinden, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari parësore 46.900 - Tregti me shumicë jo e specializuar.

Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H. operon edhe nën emrin BergerECOTRAIL dhe është e specializuar në dizajnimin dhe prodhimin e pajisjeve të lehta transportuese, veçanërisht të gjysmërimorkiove të lehta me mushama (ceradë) dhe shasive të lehta për cisterna. Përveç konstruksionit të lehtë, ekspertiza dhe fokusi i kompanisë janë drejtuar drejt optimizimit të kapacitetit mbajtës.

Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H. prodhon produkte me konstruksion të lehtë për transportin e mallrave në industri të ndryshme, duke përfshirë produktet ushqimore, pijet, materialet e ndërtimit, çelikun, ngarkesat e përgjithshme dhe teknikën e bardhë. Përveç kësaj, zhvillohen edhe zgjidhje të individualizuara të specializuara.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Berger Fahrzeugtechnik Ges.m.b.H. nuk ka prani të regjistruar, megjithatë në vitin 2025 ka realizuar një qarkullim të papërfillshëm përmes shitjes së gjysmërimorkiove të lehta me shasi për cisterna.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ